Albanian-American Development Foundation

CleanScore

# KONKURSI I PRANIMIT

# NË

# FAKULTETIN E ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS/ TROJET

## Vitin akademik 2025 – 2026

VARIANTI 1

1) Studimi i evolucionit të njeriut përmes fosileve quhet:
A) Arkeologji B) Etnografi C) Linguistikë D) Paleontologji

2) Cila nga veprat e mëposhtme nuk ka autor Caravaggio-n?
A) "Narcisi" B) "Davidi me kokën e Golias"
C) "Meduza" D) "Mëshira"

3) Në cilin projeksion segmenti AB është në madhësi reale?




A) në azbz B) në a''b'' C) në a'b' D) në ab

4) Cila nga këto shtete NUK është monarki?
A) Suedia B) Belgjika C) Austria D) Spanja

5) Kompletoni figurën e saktë.





A)


B)


C)


D)

6) Sa janë përmasat e pllakës në dyshemenë e dhomës të paraqitur në plan, referuar përmasimit në cm të dollapit ?




A) 30 me 30 cm B) 45 me 45 cm C) 60 me 60 cm D) 40 me 40 cm

7) Cilat nga grupimet e sekuencave të mëposhtme i përshtaten grafikisht diagramës?



A) {R, A, K, S, D, J}; {V, R, J, E, Q, B}; {C, L, T, Y, B, X}
B) {R, M, X, B, K, D}; {S, V, T, B, K, D}; {S, E, T, M, K, D}
C) {13, 17, 3, 8, 9, 5}; {7, 1, 2, 11, 12, 4}, {10, 11, 0, 9, 15, 13}
D) {2, 6, 10, 0, 4, 3}; {8, 1, 9, 11, 5, 7}; {0, 6}

8) Themeluesi i Microsoft është:
A) Bill Gates B) Mark Zuckenberg
C) Steve Jobs D) Elon Musk

9) "O Flamur gjak, o flamur shkabë, / O vënd e vatr' o nën' e babë, / Lagur me lot, djegur me flagë, / Flamur i kuq, flamur i zi". Kush i ka shkruar këto vargje?
A) Asdreni B) Migjeni
C) Andon Zako Çajupi D) Fan Noli

10) Shqipëria u anëtarësua në NATO në vitin:
A) 2014 B) 1999 C) 2009 D) 2004

11) Cilat nga katër figurat korespondon me kompozimin e bërë, simetrike me të rreth një boshti vertikal?




A) 4 B) 3 C) 1 D) 2

12) Kush është autori i veprës së titulluar "Guernica", e ilustruar më poshtë?



A) Paul Gauguin B) Georges Braque C) Pablo Picasso D) Paul Cézanne

13) Ngjyra portokalli arrihet përmes kombinimit të:
A) Ngjyrës së kuqe me të verdhën
B) Ngjyrës së kuqe me jeshilen
C) Ngjyrës së kuqe me blunë
D) Ngjyrës së kuqe me të bardhën

14) Dy vijëdrejta përcaktojnë një plan kur:
A) janë të kithta.
B) nuk janë paralele ndërmjet tyre.
C) kalojnë në drejtime të ndryshme.
D) ndërpriten ndërmjet tyre.

15) Sa ditë të hëna mund të jenë maksimalisht në 45 ditë rresht?
A) 5 B) 8 C) 7 D) 6

16) Përzgjidh alternativën e cila i ka të renditura në mënyrë kronologjike lëvizjet artistike:
A) Barok; Rokoko; Neoklasicizëm; Realizëm
B) Rokoko; Barok; Neoklasicizëm; Realizëm
C) Barok; Neoklasicizëm; Realizëm; Rokoko
D) Realizëm; Neoklasicizëm; Barok; Rokoko

17) Inflacioni lidhet me:
A) Rënien e normës së interesit
B) Rritjen e çmimeve
C) Rritjen e punësimit
D) Stabilitetin ekonomik

18) Sa është lartësia e katit në prerjen e dhënë ?




A) +2.89 m B) +4.32 m C) +1.80 m D) +3.06 m

19) Fotografia e mëposhtme i përket një piktori të famshëm të artit surrealist. Për kë bëhet fjalë?



A) Salvador Dalí
B) René Magritte
C) Marcel Duchamp
D) Paul Klee

20) Në figurë paraqitet shpërthimi aksonometrik i një trupi solid gjeometrik. Cili nga trupat e dhënë i korespondon?





A) 3 B) 4 C) 1 D) 2

21) Në figurë paraqitet çatia e parë nga lart. Cila nga alternativat e dhëna paraqet pamjen ballore të saktë të saj?





A) 1 B) 3 C) 2 D) 4

22) Në apartamentin e paraqitur në planimetri, cilat ambjente janë pa dritë natyrale?



A) 3 dhe 4 B) 1 dhe 4 C) 1 dhe 6 D) 2 dhe 3

23) Cili nga objektet e mëposhtme, pozicionuar në qendër të qytetit të Tiranës, nuk i përket periudhës së Socializmit?

A) Pallati i Kongreseve
B) Universiteti i Arteve
C) Muzeu Historik Kombëtar
D) Teatri i Operës dhe Baletit

24) Në figurë paraqitet kubi në :




A) Dimetri ballore
B) Dimetri anësore
C) Izometri ballore
D) Izometri kënddrejtë

25) Cila nga veprat e mëposhtme nuk i përket lëvizjes së Kubizmit?

A) 

B) 

C) 


D) 

26) Vaksinat janë:

A) Antialergjikë

B) Mjekim kundër infeksioneve

C) Substanca që stimulojnë sistemin imunitar

D) Probiotikë

27) Një segment e ka madhësinë reale 5 cm. Ai është vizatuar në fletë në përmasën 15 cm. Cfarë shkalle është përdorur ?

A) 1:4

B) 4:1

C) 1:3

D) 3:1

28) Cila pjesë mungon për të kompletuar trupin e treguar, që të përftohet një kub?






A) 3 B) 1 C) 4 D) 2

29) Një kukull matrioshka mban 3 matrioshka të vogla brenda saj. Secila prej tyre mban nga 3 matrioshka më të vogla, e brenda secilës prej tyre rrinë edhe 2 kukulla matrioshka akoma më të vogla. Sa kukulla matrioshka kemi gjithsej?

A) 31 B) 28 C) 30 D) 29

30) Në figurë paraqitet trupi gjeometrik në aksonometri. Cila nga alternativat e dhëna paraqet projeksionet e sakta të tij?







A) 1 B) 4 C) 3 D) 2

31) Cilat nga figurat më poshtë (A,B,C,D) korrespondon me kompozimin e figurave në pasqyrë?



A) 

B) 

C) 

D) 

32) "Kush lexon libra ose dëgjon muzikë klasike e do artin. Kush e do artin e do natyrën". Nëse pohimet e mësipërme janë të vërteta atëherë është e vërtetë që:

A) Kush e do artin, dëgjon muzikë klasike.
B) Kush lexon libra, dëgjon muzikë klasike.
C) Kush e do natyrën, e do artin.
D) Kush lexon libra e do natyrën.

33) Në mitologjinë greke, Artemisa ishte hyjnesha e:

A) Dashurisë
B) Luftës
C) Detit
D) Gjuetisë

34) Një magazinë ka një sipërfaqe drejtkëndore dhe ka në brendësi të tij tre linja me rafte. Llogarisni në bazë të planimetrisë së figurës sipërfaqen e shkelshme të dyqanit.




A) $13000\ m^2$
B) $15000\ m^2$
C) $10000\ m^2$
D) $12000\ m^2$

35) Cilat nga figurat zëvendëson pikëpyetjen?



A) 

B) 

C) 

D) 

36) "Banesa me hajat" nuk është karakteristikë e banesës popullore të zonës së:

A) Elbasanit B) Tiranës C) Mirditës D) Kavajës

37) Cilit objekt i përket planimetria e ilustruar më poshtë?



A) Xhamisë së Et'hem Beut në Tiranë

B) Kishës së Shën Kollit në Voskopojë

C) Xhamisë së Plumbit në Berat

D) Kishës së Shën Mërisë në Kosinë

38) Gazi kryesor që ndikon në ngrohjen globale është:

A) Heliumi

B) Dioksidi i karbonit

C) Oksigjeni

D) Azoti

39) Planimetria e mëposhtme i përket planimetrisë së një kishe:



A) Gotike B) Rilindase C) Baroke D) Romanike

40) Në një sektor rrethi AOB me rreze 10 cm e kënd 90 gradë, është brendashkruar nje drejtkëndësh OCDE që ka brinjën OC mbi rrezen OA, dhe brinjën OE mbi rrezen OB dhe diagonalen D në harkun e rrethit. Nëse OC është 5 cm, sa është CE?

A) 7.5 cm B) 5 cm C) 8 cm D) 10 cm

41) "Barcelona Pavilion", ilustruar më poshtë u projektua nga:



A) Frank Lloyd Wright
B) Antoni Gaudí
C) Le Corbusier
D) Ludwig Mies van der Rohe

42) Një vajzë do të krijojë një lojë "puzzle"- me 6 copëza, por i ka humbur një copëz. 5 pjesët e tjera të puzzle janë petëzat më poshtë.



Cilat nga petëzat e mëposhtme formojnë figurën e puzzle dhe është petëza që vajza ka humbur?

A) 

B) 

C) 

D) 

43) "Rruga e qumështit" është:

A) Yll i vetmuar  B) Kometë  C) Galaktikë  D) Sistem diellor

44) Një qelizë, ndahet në tre qeliza të reja në një moment kohe T. Mbas një kohe 4T, duke u nisur nga një qelizë e vetme , qelizat e prodhuara janë:

A) 81  B) 9  C) 27  D) 12

45) Instituti i Lartë Politeknik, paraardhësi i Universitetit Politeknik të Tiranës, u themelua në vitin:

A) 1946  B) 1956  C) 1961  D) 1951

46) Nga veprat e mëposhtme, përzgjidh atë që nuk i përket piktorit Sali Shijaku.

A) "Mic Sokoli"  B) "Dasma Shkodrane"
C) "Nusja"  D) "Vojo Kushi"

47) Ilustrimi më poshtë është një fragment i afreskeve të Kapelës Sistine, vepër e Michelangelo Buonarroti-t dhe quhet:



A) Përmbytja e madhe  B) Lindja e Adamit
C) Gjykimi i Fundit  D) Krijimi i diellit, hënës dhe bimësisë

48) Sa cm është ngjitja e cdo bazamaku shkalle, kur janë dhënë kuotat horizontale në planimetrinë e shkallëve ?




A) 16.5 cm  B) 17 cm  C) 18 cm  D) 17.5 cm

49) Një ushtrim i dhënë në klasë për 20 nxënës është mjaft i vështirë: 12 nxënës nuk arrijnë të bëjnë asgjë, gjysma e ushtrimit zgjidhet vetëm nga 6 nxënës. Sa nxënës e zgjidhin detyrën në mënyrë të saktë?

A) jo më shumë se 6 B) 2 nga 20
C) 8 nga 20 D) jo më shumë se 8

50) Në një shtet ku taksat mbi të ardhurat janë 20 % të pagës, sa i ka të ardhurat një punëtor i cili paguan 3000 Lekë taksa në muaj?

A) 120000 Lekë B) 150000 Lekë C) 12000 Lekë D) 15000 Lekë

51) Duke zgjedhur një nga emrat e piktorëve të mëposhtëm, plotëso togfjalëshin "E kuqja e papërsëritshme e ......................".

A) Kostandin Zografit B) Onufrit
C) Konstandin Shpatarakut D) David Selenicës

52) Vincent van Gogh është piktor i njohur holandez, i cili njihet në artin figurativ si një nga përfaqësuesit e periudhës së mëposhtme:

A) Kubizmit B) Artit Abstrakt
C) Artit Nouveau D) Post-Impresionizmit

53) Në figurë paraqitet plani i disa trupave gjeometrik të parë nga lart. Cila nga alternativat e dhëna paraqet pamjen aksonometrike të saktë të tij?






A) 3 B) 4 C) 2 D) 1

54) Në filozofi, epistemologjia studion:

A) Natyrën dhe shprehjen e së bukurës në art B) Bazat konceptuale dhe teorike të politikës
C) Format dhe ligjet e mendimit D) Natyrën dhe qëllimin e diturisë

55) Njësia e rrymës elektrike është:

A) Om B) Amper C) Vat D) Volt

56) Hamami është:

A) Ushqim tradicional B) Objekt kulti
C) Hapësirë pazari D) Banjë publike

57) Tre miq shkojnë në një kurs matematike me të njëjtin mësues. Duke qenë se nuk e përballojnë dot të paguajnë leksione 1 orëshe më vete, e bëjnë leksionin, dy veta njëherësh. Cili është numri minimal i leksioneve që duhet të zhvillohen në mënyrë të tillë që secili prej tre miqve të marri pjesë në të paktën 2 orë leksioni?

A) Katër B) Dy C) Tre D) Gjashtë

58) Përmasat e formatit A3 te vizatimit janë:

A) 297 mm X 210 mm
B) 297 mm X 420 mm
C) 210 mm X 420 mm
D) 297 mm X 148 mm

59) Figura e mëposhtme çon në zhvillimin e një kubi. Ndërsa figurat më poshtë tregojnë pesë perspektiva të kubit. Vetëm 2 prej tyre janë të mundura? Cilat prej tyre?




A) 1 dhe 4 B) 3 dhe 5 C) 2 dhe 3 D) 1 dhe 2

60) Cila nga fjalitë e mëposhtme nuk është e vërtetë:

A) Rruga "Egnatia" kalon në Shqipëri, Maqedoni, Greqi, Turqi
B) Rruga "Egnatia" shtrihej deri në Kostandinopojë
C) Rruga "Egnatia" u ndërtua nga romakët në shekullin e II-të p.e.s.
D) Rruga "Egnatia" u ndërtua nga grekët në shekullin e I-rë p.e.s